

**KONTRATË
PËR SHIT - BLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR
TË SHOQËRISË
HIMARA TRAVEL SHPK**

Nr. Vendimi: 02/2024

Data/Ora e mbledhjes: 24.06.2024 / 11:00

Sot, datë 24 Qershor 2024, në selinë e shoqërisë në Himarë, Nr.pasurisë 3/6/3, objekt banimi 5 (pesë) kate, ne Zone Kadastrale 1952, Himare Vlore, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakëve/Ortaku i Vetëm të shoqërisë "Himara Travel" shpk, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, në datën 01 Prill 2024 dhe e regjistruar me numër unik M46605204A, për të nënshkruar këtë kontratë për shit-blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë si më poshtë:

Theotaq Gjergji, identifikuar me letërnjoftim me numër J41010057S, i datëlindjes 10.10.1994 lindur në Greqi dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë "Shitësi").

Dhe

Morena Sheta, identifikuar me letërnjoftim me numër J65503008E, e datëlindjes 03/05/1996, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë "Blerësi").

Megënëse:

A. **Theotaq Gjergji**, dëshiron t'i shesë 20 % të kuotat të kapitalit, që ai zotëron në shoqërinë Himara Tavel shpk.

Dhe

B. **Morena Sheta** dëshiron të blejë 20 % të kuotave të kapitalit që **Theotaq Gjergji** zotëron në shoqërinë Himara Tavel shpk.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit" me ndryshimet e mëvonshme, referuar Statut të Shoqërisë Himara Tavel shpk. si dhe mbi bazën e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. PËRMBAJTJA E KONTRATËS

1.1. Shoqëria Himara Tavel shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas ligjit shqiptar, në datën 01 Prill 2024 dhe e regjistruar me numër unik M46605204A, me kapital fillestar themeltar 12.000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë, që zotërohet 100% nga Theotaq Gjergji.

Nuk ka ndryshime të mëtejshme të vlerës së kapitalit themeltar apo numrit të kuotave dhe pjesëve të ortakëve.

1.2. Me vendimin e datës 24.06.2024 të Asamblesë së Ortakëve, të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar në masën 20% të tyre nga ana e ortakut Theotaq Gjergji dhe blerja e tyre nga ana e blerësit, Morena Sheta.

2. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

- Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, shitja e masës prej 20% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë Himara Tavel shpk nga ana e Theotaq Gjergji dhe blerja e tyre nga ana e Morena Sheta, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë të shitësit, mbi pjesët e kuotave e shitura si pasojë e këtij transaksioni shit-blerje.
- Ndërsa blerësi, Morena Sheta bëhet pronar i kuotave të shitura më sipër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e kësaj kuote, duke fituar kështu cilësinë e ortakut të vetëm në shoqëri.
- Pas realizimit të transaksionit të shit-blerjes së kuotave, kapitali ligjor i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë

me vlerë përkatësisht 9.600 (Nënte mijë e gjashtëqind) Lekë ose 80% e kapitalit ligjor e cila zotërohet nga Theotaq Gjergji dhe nga 1 kuotë me vlerë 2.400 (Dy mijë e katërqind) Lekë ose 20% e kapitalit ligjor që zotërohet nga ortaku Morena Sheta.


3. ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE


- a. Si çmim i këtij transaksioni Shit-Blerje kuotash të shoqërisë Himara Tavel shpk do të jetë shuma prej 2.400 (Dymijë e katërqind) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë.
- b. Sipas këtij përcaktimi, blerësi Morena Sheta do të paguajë në favor të shitësit, Theotaq Gjergji shumën në masën (Dymijë e katërqind) Lekë.

4. DISPOZITA TË FUNDIT

- a. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët, të cilat nuk mund të ndryshojnë kushtet e vendosura në të me pëlqimin e tyre.
- b. Çdo mosmarrëveshje mes tyre palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- c. Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqip në përputhje të plotë me vullnetin e lirë të palëve në 3 (tre) kopje të barasvlershme.

PALËT

Morena Sheta 

Theotaq Gjergji 

HIMARA TRAVEL
• M46605204A •